



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë më 02.09.2019

**NJOFTIM MBI PËRDITËSIMIN
E LISTËS SË APLIKIMEVE TË KUALIFIKUARA**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin mbi përditësimin në “Listën e aplikimeve të kualifikuara”, për fermerët aplikantë, të cilët kanë përbushur kriteret e vendosura për masat mbështetëse nr. 1, 2, 3, 4, 5, 5.1, 6 nga “Fondi i Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në VKM Nr. 128, datë 13.3.2019, të ndryshuar, “Për Përcaktimin e Kritereve Bazë, të Sektorëve që do të Mbështeten dhe Masës së Financimit për vitin 2019”, si dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr .3/1 datë 15.04.2019, për masat si më poshtë:

- **Masa 1:** Për tufën bazë të matrikulluar me dele/dhi, numri rendor i aplikimeve në fond ka ndryshuar nga numri rendor 513 në numrin rendor 550 aplikime në fond;
- **Masa 3:** Bletaria, numri rendor i aplikimeve në fond ka ndryshuar nga numri rendor 558 në numrin rendor 569 aplikime në fond;
- **Masa 5:** Mbjellje ullishte, numri rendor i aplikimeve në fond ka ndryshuar nga numri rendor 213 në numrin rendor 248 aplikime në fond;
- **Masa 5.1:** Përmirësimi ullishtesh të degraduara, vija e financimit ka shkuar në fund të listës, pasi ka patur skualifikime gjatë kontrollit administrativ të dosjes së aplikimit; numri rendor i aplikimeve në fond ka ndryshuar nga numri rendor 5 në numrin rendor 23 aplikime në fond;
- **Masa 6:** Ujitje me pika, numri rendor i aplikimeve në fond ka ndryshuar nga numri rendor 37 deri tek numri rendor 86 aplikime në fond;
- **Masa 2:** Mbështetje për dorëzimin e qumështit lëndë e parë në pikat e grumbullimit për feramat me lopë/të imta, **dhe Masa 4:** Dorëzim prodhimi për anije peshkimi, aplikimet janë në fond, sipas parimit “Kush sjell faturat i pari renditet i pari”.